

Njoftim

Sot, më datë **24.05.2023**, ora **15:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Esmeralda Xhili (Relatore);**
- 2. Edlira Petri (Anëtare);**
- 3. Emona Muçi (Anëtare);**
- 4. Marsela Dervishi (Anëtare);**
- 5. Sokol Ibi (Anëtar);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.23 Regj.Themeltar, Datë 19.05.2023 Regjistrimi, me:

Paditëse: Majlinda Bufi, përfaqësuar nga Delina Hoxha.

Të paditur: Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS).
Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

Objekti: 1. Shfuqizimi i Vendimit të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) nr.84, datë 08.05.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës nr.21, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

Baza ligjore: Neni 19, pika 1, neni 91, neni 92 dhe neni 171, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndyshuar, si edhe të vendimit nr.9 datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimeve të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

me Vendimin Nr.23, datë 24.05.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me shumicë votash,

VENDOSI

1. Pushimin e gjykimit të çështjes nr.23 Regj. Themeltar, datë 19.05.2023.
2. Dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
U shpall në Tiranë më datë 24.05.2023.

Tiranë, më 24.05.2023

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë